



“SCANDERBEG”

ASSOCIAZIONE ALBANESE A PARMA

Via Ruggero, 21/A Tel: 0521/29.15.83 info@scanderbeg.org
43100 Parma - PR Fax: 0521/04.49.01 www.scanderbeg.org
Italia Codice Fiscale: 92137750342

Banca Popolare dell'Emilia Romagna - Ag. 4

Numero del Conto: 1554833 ABI: 05387 CAB: 12701 CIN: Y

Prezantimi i Shoqatës Shqiptare “SCANDERBEG”

Eshtë shoqata e familjes, traditës, kulturës, artit e diturisë shqiptare.

Shoqata “SCANDERBEG” është krijuar për të mbështetur në rradhë të parë familjet emigrante në çdo aspekt të jetës jashtë kufirit. Të gjithë kemi parasysh fjalët kuptimplotë të Gjergj Kastriot Skënderbeu: Degët po të jenë të ndara mund ti thyesh kollaj një nga një, së bashku është e pamundur, bëhen magjike se: **“Bashkimi bën fuqinë!”** Fjalë të arta që duhen të gdhenden në ndëgjegjen e çdo shqiptari, vetëm kështu mund ti tregojmë botës që jemi një popull i lidhur e me traditë.

Fëmijët tanë, shumë prej tyre të lindur e të rritur këtu, fillojnë të harrojnë apo nuk e njohin historinë e vendit ku janë rrenjët, nuk njohin më gjuhën letrare shqiptare, traditat e bukura. Kjo i çon në indiferentizëm apo në mohimin e plotë të prejardhies. Një ndër pikat e rëndësishme, në planin e kësaj shoqate, është tërheqia e familjeve, e fëmijeve, e të rinjëve, e studentëve në kujtimin, njohien e vazhdimsinë e traditës, gjuhës, historisë. Duke ushqyer respekt, krenari e dashuri për tokën e popullin tonë të mrekullueshëm. Në çdo moment gëzimi apo hidhërimi shoqata do të jetë e pranishme duke dhënë kontributin e saj.

Të qenurit shqiptar nuk duhet të prezantoj një rrezik, një turp, një mohim të vetvetes. Të qenurit shqiptar duhet të prezantojë krenari kombëtare, dhuntinë puntore e të sakrificës që karakterizon populli tonë, pa harruar pasurinë shpirtërore, atë të artit, diturisë e kulturës. Këtë shoqata mendon ta zhvillojë me anë të linjës së komunikimit, gazetës së vet. Me anë të financimit e të organizimit të koncerteve në bashkëpunim me artin dhe kulturën shqiptare. Me anë të organizimit të mbrëmjeve tematike të lidhura jo vetëm me dëfrimin por edhe me shkëmbim reciprok Italo- Shqiptare, duke ftuar këtu përfaqësues të shkencës, artit dhe letërsisë nga të dyja vendet. Kështu memoria jonë do të freskohet dhe njerëzit që na rrethojnë do të kenë mundësinë të na njohin më mirë. Ne dhe vetëm ne kemi në dorë të eliminojmë kronikën e zezë e cila, pothuajse çdo ditë, ka në qendër të vëmendjes bashkëatdhetarët tanë.

Përse të mos besojmë në forcën tonë, në kapacitetin tonë intelektual, në kapacitetin tonë për të demonstruar vlerat e jetës, parimet e traditat e familjes shqiptare, si pjesë e pandarë e asaj toke që rradhitet në vendet më të lashta në Evropë. Shoqata “SCANDERBEG” mirëpret bashkëpunimin, për shkëmbimin reciprok të eksperiencës së jetës, me popullin e Parmës dhe organet drejtuese të saj. Në këtë drejtim pjesëmarrja në shoqatë është e hapur për të gjithë.

Në programin e shoqatës pikat kryesore janë:

- Shkolla shqipe, të gjitha funksionet edukuese, mësimdhënëse, kulturore të saj.
- Shtypi ynë në gjuhën shqipe. Do të jetë një gazetë periodike me lajme nga jeta këtu dhe informacione, në linja të përgjithshme, me të reja nga Shqipëria.
- Krijimi e një skuadre futbollit.
- Organizimi një herë në vit i festës së fëmijëve çdo 1 qershor.
- Organizimi i Festës Sonë Kombëtare, më 28 Nëntor të çdo viti.
- Festa e nënës dhe e gruas në 8 mars.
- Të tjera ide janë organizimi i koncerteve, ekspozita, shkëmbime kulturore ndërjmjet dy popujve etj.
- Dita e librit dhe e letërsisë ku mund të jenë të ftuar edhe shkrimtar me zë nga vendi ynë.
- Festa e guzhinës Shqiptare. Gratë emigrante shqiptare do të kenë rastin të jenë të pranishme, me një specialitet të tyre, në një konkurim simpatik, duke ftuar edhe një çmim simbolik.
- Konkursi i bukurisë e stilit shqiptar. Me vajzat tona të bukura që jetojnë këtu, etj.



Via Ruggero, 21/A - 43100 PARMA
Tel. +39 0521.291583 - Fax +39 0521.044901
Info@scanderbeg.org www.scanderbeg.org
Cod. Fisc. 92137750342

Bëhu edhe ti anëtar i shoqatës sot!